

1. VEPRIMTARIA E KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Procesi i vendimmarrjes në Bankën e Shqipërisë udhëhiqet nga parimet e ligjshmërisë, profesionalizmit, pavarësisë dhe transparencës. Organi më i lartë vendimmarrës dhe mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë është Këshilli Mbikëqyrës. Ky organ përbëhet prej nëntë anëtarësh të zgjedhur dhe të emëruar nga Kuvendi i Shqipërisë.

Këshilli Mbikëqyrës ka përgjegjësinë përfundimtare për të vendosur mbi strategjinë e Bankës së Shqipërisë, emërimin e drejtuesve të departamenteve, miratimin e strukturës organizative, si dhe përmbushjen e detyrimeve në lidhje me administrimin e rrezikut dhe përputhshmërisë.

Në funksion të rritjes së eficiencës, funksionet e auditimit të brendshëm i janë deleguar Komitetit të Auditit, i cili është përgjegjës për procesin e raportimit financiar dhe sistemin e kontrollit të brendshëm.

Këshilli Mbikëqyrës i ka ushtruar kompetencat e tij në përputhje me dispozitat e ligjit organik dhe me procedurat e parashikuara në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e këtij organi.

Për vitin 2017, në veprimtarinë e Këshillit mund të evidentohen: (i) krijimi i Departamentit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme; (ii) miratimi i Strategjisë së Politikës Makroprudenciale; (iii) miratimi i nivelit të tolerancës ndaj rrezikut operacional në Bankën e Shqipërisë; dhe (iv) përditësimi i Strategjisë Afatmesme të Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë.

KËSHILLI SI ORGANI MË I LARTË VENDIMMARRËS I BANKËS SË SHQIPËRISË

Këshilli zhvilloi 15 mbledhje gjatë vitit 2017. Tetë prej këtyre mbledhjeve u përqendruan te shqyrtimi dhe miratimi i politikës monetare, të ndara në 4 mbledhje tremujore dhe 4 të ndërmjetme. Në këto mbledhje, pasi është njohur me zhvillimet më të fundit makroekonomike dhe të faktorëve që ndikojnë në ecurinë e çmimeve të konsumit në vend, Këshilli ka marrë vendime për normat kryesore të interesit.

Gjatë gjithë vitit 2017, Këshilli i ka mbajtur të pandryshuara normat kryesore të interesit, përkatësisht: (i) normën bazë të interesit në nivelin 1.25%; (ii) normën e interesit për depozitën njëditore në nivelin 0.25%; dhe (iii) normën e interesit për kredinë njëditore në nivelin 2.25%.



Katër mbledhje i janë dedikuar analizimit të zhvillimeve në sektorin bankar dhe të subjekteve financiare jobanka. Në mbledhjet e tjera janë trajtuar: (i) programi vjetor i Këshillit; (ii) raporti vjetor i Bankës së Shqipërisë; dhe (iii) strategjia afatmesme, buxheti vjetor dhe ai afatmesëm.

a. Vendimarrja

Këshilli ka kompetencë miratimin e të gjitha vendimeve, rregulloreve dhe udhëzimeve me zbatim të përgjithshëm që nxirren nga Banka e Shqipërisë.

Në vitin 2017, Këshilli ka miratuar 82 vendime, prej të cilave, 61 ishin akte të miratuara për herë të parë dhe 21 ndryshime ose plotësime aktesh ekzistuese. Këshilli ka miratuar 29 rregullore (8 ishin të reja dhe 21 ndryshime rregulloresh ekzistuese) dhe 1 udhëzim me zbatim të përgjithshëm.

Aktet e mësipërme janë nxjerrë në përmbushje të detyrave të Këshillit, siç përcaktohen në ligjin organik, si: (i) stabiliteti monetar; (ii) licencimi, rregullimi dhe mbikëqyrja e bankave dhe institucioneve të tjera financiare; dhe (iii) ofrimi i infrastrukturës financiare (emisioni i kartëmonedhës dhe monedhës, funksionimi i Sistemit Qendror të Regjistrimit dhe Shlyerjes së Titujve, statistikat etj.).


b. Drejtimi dhe organizimi i brendshëm

Ligji organik përcakton se Këshilli është përgjegjës për: (i) miratimin e Statutit dhe rregulloreve të brendshme të Bankës së Shqipërisë; (ii) përcaktimin e strukturës organizative; dhe (iii) miratimin e drejtuesve të departamenteve dhe përcaktimin e kushteve të punësimit në Bankën e Shqipërisë.

Në nëntor, Këshilli miratoi Strategjinë Afatmesme të Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë për periudhën 2018-2020, e cila përbën një përditësim të Strategjisë 2016-2018. Përditësimi ishte i nevojshëm përpara miratimit të buxhetit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2018 dhe buxhetit orientues afatmesëm për vitet 2019-2020.

Strategjia përfshin funksionet kryesore të Bankës së Shqipërisë: politikat (politika monetare, rezerva valutore, mbikëqyrja bankare), infrastrukturën financiare (emisioni i parasë, sistemet e pagesave); funksionet e tjera (kërkimet, statistikat); dhe shërbimet mbështetëse (burimet njerëzore, çështjet juridike, kontabiliteti dhe financa, prokurimet dhe shërbimet, IT).

Në muajin mars, në përfundim të periudhës së provës, Këshilli miratoi emërimin e drejtorit të Departamentit të Statistikave Financiare.



c. Buxheti

Këshilli vendos për buxhetin e Bankës së Shqipërisë, politikat e administrimit dhe për procedurat e përdorimit të mjeteve financiare për realizimin e veprimtarisë operative të institucionit.

Në nëntor, Këshilli miratoi buxhetin vjetor 2018 dhe buxhetin orientues afatmesëm për vitet 2019-2020. Buxheti u hartua në përputhje me objektivat e Strategjisë Afatmesme të Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë, si dhe me parashikimet e departamenteve në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën afatmesme. Për herë të parë këtë vit, shpenzimet kapitale dhe projektet e përfshira në buxhet u miratuan paraprakisht në Komitetin e Shpenzimeve Kapitale.

Buxheti synon plotësimin e funksioneve kryesore, zhvillimin normal të veprimtarisë dhe përmbushjen e objektivave strategjike të Bankës së Shqipërisë. Ai bazohet në situatën aktuale në tregjet ndërkombëtare, zhvillimet e tregut të brendshëm, planin e shpenzimeve kapitale, si dhe reflekton shpenzimet e nevojshme operative për miradministrimin e aktiveve dhe burimet njerëzore.

KËSHILLI SI ORGANI MË I LARTË MBIKËQYRËS I BANKËS SË SHQIPËRISË

Këshilli e konsideron me rëndësi të veçantë ushtrimin e përgjegjësisë së tij mbikëqyrëse mbi politikat, administrimin dhe operacionet e Bankës së Shqipërisë.

Për sigurimin e respektimit korrekt të ligjit dhe akteve të tjera që rregullojnë veprimtarinë e përditshme të institucionit, Këshilli është informuar rregullisht nga hallkat e kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm.

a. Kontrolli i brendshëm

Kontrolli i brendshëm është një veprimtari e pavarur nga administrimi që ofron vlerësim, raportim dhe siguri objektive, si dhe përfshin funksionet e përputhshmërisë, auditimit të brendshëm dhe administrimit të rrezikut.

i. Kontrolli mbi administrimin

Sipas ligjit organik, Guvernatori përgjigjet përpara Këshillit për zbatimin e vendimeve të miratuara, si dhe për drejtimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen mbi administrimin dhe operacionet e Bankës së Shqipërisë.

Administratorët (Guvernatori dhe dy zëvendësguvernatorët) kanë informuar çdo muaj Këshillin Mbikëqyrës mbi zhvillimet ekonomike, financiare dhe monetare, në përmbushje të detyrimeve ligjore.



Këshilli është informuar edhe mbi politikat e administrimit të institucionit dhe mënyrat e përdorimit të mjeteve financiare për realizimin e veprimtarisë operative të Bankës së Shqipërisë. Në mënyrë të përmuajshme, janë paraqitur informacione mbi pozicionin dhe rezultatin financiar të Bankës së Shqipërisë dhe mbi ecurinë e administrimit të rezervës valutore.

ii. Veprimtaria e Komitetit të Auditit

Në funksion të përmirësimit të vendimmarrjes së Këshillit dhe drejtimit të institucionit, Komiteti i Auditit ushtron detyrat e tij në mbështetje të përforcimit të linjave të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm. Ky komitet, është përgjegjës për: (i) procesin e raportimit financiar; (ii) sistemin e kontrollit të brendshëm; (iii) auditin e brendshëm dhe të jashtëm; si dhe (iv) përputhshmërinë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Komiteti përbëhet nga tre anëtarë të Këshillit, të emëruar nga Këshilli, për një periudhë trevjeçare. Anëtarët e Komitetit janë: z. Petraq Milo (Kryetar), zj. Ela Golemi dhe zj. Denada Prifti, të emëruar në maj 2015.

Gjatë vitit 2017, Komiteti i Auditit u mbledh gjashtë herë. Në këto mbledhje janë diskutuar çështje si: (i) plani vjetor i punës, (ii) hartimi i pasqyrave financiare, (iii) auditimi i jashtëm, (iv) ecuria e angazhimeve të Departamentit të Kontrollit, si dhe (v) buxheti vjetor e afatmesëm.

Marrëdhënia me Inspektorin e Përgjithshëm është realizuar përmes takimeve të rregullta, pa praninë e administratorëve, ku janë trajtuar organizimi i Departamentit të Kontrollit, plani vjetor i auditimit dhe ecuria e angazhimeve. Realizimi i këtyre takimeve u ka mundësuar anëtarëve të Komitetit njohjen me sistemet e kontrollit të brendshëm dhe administrimin e rreziqeve.

Inspektori i Përgjithshëm ka informuar rregullisht Komitetin dhe, më pas Këshillin, për gjetjet dhe rekomandimet e auditimeve të Departamentit të Kontrollit, të cilat ofrojnë një garanci të pavarur mbi efektivitetin dhe cilësinë e sistemeve të mësipërme.

Komiteti i Auditit ka zhvilluar një takim, në muajin mars, me auditorin e jashtëm (KPMG) për të diskutuar mbi auditimin për vitin 2016 dhe certifikimin e pasqyrave financiare. Në takim, auditori i jashtëm u ka komunikuar anëtarëve të Komitetit: (i) gjykimet e veta mbi parimet kontabël në Bankën e Shqipërisë të zbatuara në raportimin financiar; (ii) çështjet kryesore të diskutuara me administrimin gjatë procesit të auditimit, veçanërisht ato që kanë rëndësi për pasqyrat financiare dhe raportin e auditimit; dhe (iii) vështirësitë kryesore të hasura gjatë procesit të auditimit. Komiteti u njoh edhe me risitë që përfshiu raportimi i këtij viti nga auditori i jashtëm, si rezultat i adoptimit të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).



Anëtarët e Komitetit kanë zhvilluar mbledhje me drejtuesin e departamentit përgjegjës për financën për të diskutuar çështje si: përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, kontrolli i brendshëm mbi raportimin financiar, ecuria e procesit të auditimit të jashtëm, dhe hartimi i buxhetit vjetor e afatmesëm.

iii. Auditimi i brendshëm

Inspektori i Përgjithshëm dhe Departamenti i Kontrollit, në mënyrë periodike dhe të pavarur: (i) vlerësojnë llogaritë dhe regjistrat kontabël, procedurat e administrimit dhe operacionet e Bankës së Shqipërisë, me qëllim sigurimin e zbatimit të ligjeve dhe të akteve nënligjore; dhe (ii) ofrojnë siguri të arsyeshme për efektivitetin e sistemit të kontrollit, administrimit të rrezikut dhe proceseve të drejtimit, në funksion të përmbushjes së objektivave institucionale.


Bazuar në Politikën e Auditimit të Brendshëm, Këshilli miratoi planin e punës së Departamentit të Kontrollit për vitin 2017, i cili kishte marrë miratimin paraprak të Komitetit të Auditit. Plani vjetor i punës mbështetet në standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm dhe në vlerësimin e përditësuar të rrezikut për funksionet e identifikuar në universin e rishikuar të auditimit. Ai reflekton edhe sugjerimet e Këshillit, Komitetit të Auditit dhe administratorëve lidhur me funksionet/proceset që vlerësohen të nevojshme të auditohen, apo kërkesat për këshillim/investigim mbi çështje specifike, si dhe në buxhetin e disponueshëm për vitin.

Inspektori i Përgjithshëm ka raportuar rregullisht në Këshill për realizimin e këtij plani dhe rezultatet e angazhimeve të auditimit.

iv. Administrimi i rrezikut

Në mars, Këshilli miratoi, për herë të parë, nivelin e tolerancës ndaj rrezikut operacional në Bankën e Shqipërisë. Rreziqet operationale të mbetura (reziduale), të klasifikuara si "të larta" dhe "të mesme", sipas vlerësimit periodik të Inspektorit të Përgjithshëm, tashmë trajtohen në përputhje me procedurat e parashikuara në Politikën për Administrimin e Rrezikut Operacional. Miratimi i nivelit të tolerancës u diskutua paraprakisht në Komitetin e Auditit. Administratorët, pas konsultimit të përbashkët, mund të vendosin për mënyrën e trajtimit të rrezikut, në përputhje me Politikën dhe nivelin e tolerancës së përcaktuar nga Këshilli.

Në dhjetor, u miratua rregullorja "Për hetimin administrativ të sinjalizimit, për mbrojtjen e konfidencialitetit dhe për mbrojtjen nga hakmarrja në Bankën e Shqipërisë". Rregullorja vjen në zbatim të ligjit përkatës dhe synon parandalimin dhe goditjen e korrupsionit, nxitjen e sinjalizimeve mbi veprimet ose praktikatat e dyshuara të korrupsionit dhe mbrojtjen e punonjësve sinjalizues.



b. Kontrolli i jashtëm

Ligji organik parashikon se llogaritë dhe regjistrat e Bankës së Shqipërisë mund të kontrollohen nga auditorë të jashtëm të institucioneve audituese të njohura në arenën ndërkombëtare që caktohen nga Këshilli. Auditori i jashtëm shpreh opinionin e tij nëse raportet e përgatitura nga Banka e Shqipërisë paraqesin në mënyrë të plotë dhe të drejtë situatën financiare të institucionit, në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranura përgjithësisht të kontabilitetit.

Pasqyrat financiare të Bankës së Shqipërisë auditohen për të ofruar siguri të arsyeshme se ato nuk kanë pasaktësi, si rezultat i gabimeve apo mashtrimit. Kjo i mundëson auditorit të jashtëm një rol kyç në ruajtjen e besimit të tregjeve financiare dhe publikut në raportimin financiar të Bankës së Shqipërisë.

Komiteti i Auditit shqyrton efektivitetin dhe përshtatshmërinë e funksionit të auditimit të jashtëm. Përpara dorëzimit të opinionit mbi pasqyrat financiare, Komiteti takohet me auditorin e jashtëm, pa praninë e administratorëve, ku diskutohet ecuria e procesit të auditimit.

LLOGARIDHËNIA DHE TRANSPARENCA

Këshilli ka përmbushur rregullisht detyrimet e llogaridhënies së Bankës së Shqipërisë ndaj Kuvendit dhe detyrimet e transparencës ndaj publikut, sistemit financiar dhe mediave.

Këshilli miraton të gjitha raportet dhe rekomandimet që i paraqiten Kuvendit ose Këshillit të Ministrave, si dhe raportet vjetore e financiare të Bankës së Shqipërisë. Këto raporte shpjegojnë vendimmarrjen e institucionit dhe performancën e saj në përmbushjen e objektivave ligjorë.

a. Miratimi i raportit vjetor

Në muajin mars, Këshilli miratoi dhe dërgoi në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave raportin vjetor 2016, i cili përshkruan gjendjen ekonomiko-financiare të vendit dhe veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë gjatë vitit në fjalë. Pjesë përbërëse e raportit vjetor ishin edhe pasqyrat financiare dhe opinionin e auditorit të jashtëm. Raportit vjetor iu bashkëlidh një informacion për veprimtarinë dhe rezultatet vjetore të Departamentit të Kontrollit për periudhën janar-dhjetor 2016. Ky dokument përbën një instrument shtesë në drejtim të llogaridhënies së institucionit.

b. Miratimi i pasqyrave financiare

Pjesë përbërëse e raportit vjetor ishin edhe pasqyrat financiare të kontrolluara dhe certifikuara nga auditori i jashtëm dhe opinionin e tij. Pasqyrat financiare



u audituan nga KPMG Albania. Mbështetur në rishikimin e Standardit Ndërkombëtar të Auditimit 720 "Përgjegjësitë e audituesit në lidhje me informacionet e tjera", audituesi shfrytëzoi edhe informacione të tjera nga raporti vjetor 2016, për të konsideruar nëse këto informacione ishin materialisht jokonsistente me pasqyrat financiare.

Sipas opinionit të KPMG Albania, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Bankës së Shqipërisë më 31 dhjetor 2016, të performancës së saj financiare dhe të flukseve të saj të parasë, në përputhje me SNRF-të.

c. Shpërndarja e fitimit

Në mars, Këshilli miratoi shpërndarjen e fitimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2016 dhe pasqyrat financiare, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Vlera e fitimit neto të realizuar gjatë vitit 2016 ishte 908,214,091.75 lekë (llogaritur si diferencë midis të ardhurave neto nga veprimtaria e Bankës së Shqipërisë 982,011,140.77 lekë dhe provigjioneve neto 73,797,049.02 lekë).

Fitimi miratohet me një vendim të ndarë nga ai i miratimit të pasqyrave financiare, të cilat pasqyrojnë vlerën e fitimit për t'u shpërndarë. Vlera e fitimit vendoset paraprakisht, në përputhje me ligjin organik që parashikon të gjitha zbritjet e mundshme, objekt miratimi nga Këshilli, përpara shpërndarjes.

d. Raportimi për Kuvendin dhe Këshillin e Ministrave

Sipas ligjit organik, Banka e Shqipërisë duhet të publikojë: (i) një opinion të detajuar mbi gjendjen e ekonomisë, çdo tre muaj; dhe (ii) një deklaratë për kërcënimet mbi stabilitetin e sistemit financiar, çdo gjashtë muaj.

Vendimmarrjet e politikës monetare në muajt shkurt, maj, gusht dhe nëntor, janë shoqëruar me publikimin e raporteve tremujore të politikës monetare, të cilat përbëjnë instrumentin kryesor të llogaridhënies dhe transparencës në këtë fushë. Këto raporte paraqesin një tablo gjithëpërfshirëse të zhvillimeve të fundit makroekonomike dhe faktorëve që ndikojnë në ecurinë e çmimeve të konsumit në vend.

Në muajt mars dhe shtator, Këshilli ka diskutuar dhe miratuar raportet gjashtëmujore të stabilitetit financiar. Këto raporte japin vlerësimet e Bankës së Shqipërisë për zhvillimet e sistemit financiar shqiptar, theksojnë rreziqet potenciale ndaj stabilitetit financiar dhe japin rekomandime në lidhje me masat e nevojshme për të reduktuar rreziqet.

Raportet u janë dërguar Kuvendit, Këshillit të Ministrave dhe institucioneve të tjera qendrore.

